URDHËR
Nr. 5206, datë 30.7.2015

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9000, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të nenit 7 pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar, të nenit 27 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë nga data 21.8.2015 deri në datën 31.8.2015, zëvendësministrit të Drejtësisë z. Arben Isaraj.
2. Ngarkohet zëvendësministri i Drejtësisë z. Arben Isaraj, për zbatimin e këtij urdhri.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Nasip Naço